

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.15 /2024	Data: 31.01.2024	

Kuvendi i Komunës në baze të nenit 40 paragrafi 40.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 33 paragrafi 33.1 pika 4 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, në mbledhjen e mbajtur me 31.01.2024 Shqyrtoj Raportin Vjetor te Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve për vitin 2023 - Istog, dhe nxjerri këtë:

NJOFTIMIN ME
RAPORTIN VJETOR I EKIPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE PËR VITIN
2023 - ISTOG

1. Kuvendi i Komunës shqyrtojë dhe debatoj Raportin Vjetor te Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve për vitin 2023 - Istog.
2. Raporti është pjesë përbërës e këtij njoftimi.
3. Me kopje të këtij Njoftimi të njoftohen: Zyra përgjegjëse e këtij raporti dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendi.

	REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK DREJTORATI PËR ADMINISTRATË - DIREKCIJA UPRAVE	
Nr./Br. <u>00-033-13</u> Nr. i faq/Br.str <u>01</u>		
Data/Datum <u>07 / 02 / 2024</u> ISTOG • ISTOK		

Kryesuesi i Kuvendit
 z. Enver Rugova

Enver Rugova



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

02 Nr.Br 167/2023

Data: 20.12.2023

Raporti Vjetor i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës - Istog

Me datë 01.12.2022 në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete - Drejtoria për Administratë Komunale, është bërë Shkresa për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës Nr. 06/L-084, ku janë të përcaktuara obligime për komuna dhe rrjedh si obligim edhe formimi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-084, nenin 8. të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.06/2022 për Themelimin dhe Funksonimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është nxjerrë Vendimi për formimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës – Istog me datë 03.03.2023 Nr.Br.01-218/023 në të cilin janë caktuar anëtarët në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.06/2022.

Përgjatë vitit 2023 janë mbajtur tri takime të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës:

1.Takimi i parë Konstituiv i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është mbajtur më datë 21.09.2023 dhe është udhëhequr nga Kryetari i Komunës së Istogut z. Ilir Ferati, si Kryesues i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

Si pika diskutimi në takimin e parë të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës ishin:

- Njoftimi i anëtarëve të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës më qëllimin e Udhëzimit Administrativ 06/2022 për Themelimin dhe Funksonimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.
- Puna, mandati dhe përgjegjësitë e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës që qytetarët e Istogut të jenë të informuar për ekzistimin e këtij mekanizmi shumë të rëndësishëm në nivel lokal për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.
- Angazhimi i të gjithë anëtarëve të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës për një punë të përbashkët më qëllim që të mbrojmë interesin më të mirë të fëmijës dhe të sigurojmë një mjedis të sigurt dhe respektim të drejtave të fëmijëve në komunën tonë.
- Zgjedhja e Sekretariatit për të Drejtat e Fëmijës - zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim dhe detyrat dhe përgjegjësit që do ti bart si Sekretariat i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës
- Hartimi i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës (2024-2026)

2.Takimi i dytë i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është mbajtur me datë 03.10.2023 dhe është udhëhequr nga zëvendëse kryesuesja e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës znj.Meritë Bytyçi

dhe Sekretariati i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës - zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim znj.Vlora Gjoci.

Qëllimi i takimit të dytë të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës ishte Hartimi i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026).

Në këtë takim nga z.Naser Lajqi - Udhëheqës i Programeve për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve, OJQ " Syri i Vizionit", në cilësinë e ekspertit për hartimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026) janë shtjelluar dhe është punuar mbi gjashtë fushat të cilat janë të përfshira në Plan nga anëtarët Ekipit:

Shërbime cilësore e gjithëpërfshirëse për fëmijët; Vetëdijesimi dhe avokimi për fëmijë; Hapësira të sigurtë e miqësore për fëmijë; Sporti, loja dhe rekreacioni për fëmijë; Pjesëmarrja e Fëmijëve në Vendim marrjen; Koordinimi, vlerësimi e raportimi

Pas përfundimit të hartimit Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026), me datë 12.10.2023 është mbajtur Dëgjimi Publik Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026).

Me datë 20.10.2023 është mbajtur Komiteti për Politikë dhe Financa ku është shqyrtuar dhe miratuar Plani i Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026).

Me datë 30.10.2023 në Kuvendin e Komunës është miratuar Plani i Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026).

3.Takimi i tretë i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës me zyrtarë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në koordinim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/ZQM dhe në bashkëpunim me organizatat "Syri i Vizionit" dhe "Save the Children zyra në Kosovë" është mbajtur më datë 09.11.2023 dhe është udhëhequr nga zëvendëse kryesuesja e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës znj.Meritë Bytyçi dhe Sekretariati i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës - zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim znj.Vlora Gjoci.

Qëllimi i takimi të tretë i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës ishte promovimin i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në kuadër të fushatës për promovimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe diskutimin për planet e MAPL-së, dhe ZQM-së lidhur me ndihmën dhe monitorimin që do ju bëhet ekipeve dhe planeve të tyre të punës si dhe mundësitë e përfshirjes së indikatorëve të Planeve të Punës në grandin e performancës për komuna nga ana e MAPL-së.

Procesmbajtëse SEDF:
Zyrtarja për Mbrojtje
të Fëmijëve dhe Riintegrim
znj.Vlora Gjoci



Kryesues i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës
Kryetari i Komunës
z.Ilir Ferati

